



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 693/Prot  
/4

Tiranë, më 29.07.2016

VENDIM

Nr. 46, datë 29.07.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit *Drejtoria Arsimore Rajonale Fier*, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit Nr. 155, datë 20.06.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 28.06.2016 e në vazhdim, grupi i inspektimit, filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit, *Drejtoria Arsimore Rajonale Fier*, me objekt:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar dhe akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri nga kontrolluesi *Drejtoria Arsimore Rajonale Fier*, gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij në fushën e arsimit

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin Nr.155, datë 20.06.2016 të Komisionerit "*Për kryerjen e hetimit administrativ*" që do të ushtrohej pranë këtij kontrolluesi.

**Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:**

1. Kontrolluesi nuk ka rregullore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale;
2. Kontrolluesi aplikon për disa punëmarrës (mësuesit mbikqyrës për provimet e maturës) D.A.R. - Fier "*Deklaratën e Konfidencialitetit*", por nuk e ka aplikuar për të gjithë punëmarrësit/mësuesit/psikologët e shkollave.
3. Konstatohet se dosjet personale të krijuara nga psikologët e gjimnazeve ruhen për një periudhë 3-vjeçare nga shkëputja e subjektit të të dhënave "*nxënës*", por kjo gjë nuk është e përcaktuar në rregulloret apo udhëzimet e brendshme.
4. Konstatohet se në portalin e kontrolluesit [www.darfier.arsimi.gov.al](http://www.darfier.arsimi.gov.al), janë publikuar rezultatet e testimit të mësuesve. Konstatohet se një prej tabelave të publikuara përmban

listën përfundimtare e portalit për pikët e testimit të mësuesve, ID\_në e testimit, pikët, nr. personal (ID unike) e subjektit të të dhënave, lënda etj.

5. Konstatohet se DAR-Fier administron vetëm një adresë zyrtare të postës elektronike (e-Mail) dhe të gjithë punëmarrësit komunikojnë nëpërmjet postës elektronike personale ndërmjet njëri-tjetrit. Adresa e postës elektronike mundësohet nga M.A.S.

**Faktet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.**

**Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Rregullore e brendshme e funksionimit të D.A.R. Fier;
- Kod i etikës dhe sjelljes;
- Deklaratë konfidencialiteti;
- Manual i shërbimit psikologjik shkollor;
- Printim nga portali [www.darfier.arsimi.gov.al](http://www.darfier.arsimi.gov.al) i tabelës së të dhënave të mësuesve që kanë aplikuar në portalin “Mësues për Shqipërinë”;
- Praktikë e psikologut të shkollave në lidhje me Personat me Aftësi të Kufizuara.

Në zbatim të kërkesave të Urdhrit Nr.155, datë 20.06.2016, u krye intervistimi i përgjegjësës së departamentit psikosocial, ku në fokus të këtij intervistimi ishte rregullorja për mbrojtjen e të dhënave personale, të nxënësve me probleme sociale, fëmijve me probleme të shëndetit mendor, apo fëmijve me zhvillim psikomotor të vonuar, apo dhe nxënësve problematikë. Rregullore tipike për mbrojtjen e të dhënave personale për informacion sensitiv të nxënësve me probleme, nuk kishte.

Përfaqësuesit e kontrolluesit u shprehën se, parimin bazë të konfidencialitetit, sidomos për këtë kategori, e kishin tashmë praktikë pune, si detyrim që buron nga “Manuali i Shërbimit Psikologjik Shkollor” dhe Neni 46, paragrafi 10 i Dispozitave Normative për Sistemin Parauniversitar, i vitit 2013 nga MAS-i, i cili parashikon: “Informacioni për nxënësit edhe familjet e tyre, të marra për shkak të detyrës nga psikologu/punonjës social, ruhet në dosje. Dosja është është e siguar nga përdorimi i saj prej personave të paautorizuar”. Si dhe mund të shihet, këto dispozita janë më të hershme se Udhëzimi Nr.12 datë 27.04.2015 i MAS-it, dhe çfarë është më e rëndësishme si manuali dhe dispozitat, konfidencialitetin e kanë trajtuar thjesht si parim dhe jo si tërësi rregullash dhe proces i vazhdueshëm pune.

Kontrolluesi D.A.R Fier, rregullon aktivitetin e vet sipas rregullores funksionale të miratuar nga MAS, dhe nuk kishte dijeni për hartimin e rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale, qoftë dhe në përmbushje të detyrimeve që burojnë prej Udhëzimit Nr.12 datë 27.04.2015, dalë nga institucioni epror MAS-i.

Në lidhje me publikimin e tabelës me rezultatet e testimit profesional të mësuesve në portalin e kontrolluesit, përfaqësuesit e tij interpretuan se ky publikim ishte një kërkesë në funksion të nenit 130 dhe 131 të Dispozitave Normative të MAS-it. Parë në këndvështrimin e Zyrës së Komisionerit, publikimi i ID-së unike në faqen të D.A.R. Fier është i tepërt, cënon privatësinë e

mësuesve aplikantë, ku kandidatët identifikohen edhe vetëm nëpërmjet një kodi personal, konform Udhëzimit Nr.38, datë 06.10.2015 i MAS-it.

Në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, por veçanërisht dhe në mbështetje të Udhëzimit të MAS-it Nr.12, datë 27.04.2015 "Për mbledhjen përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe përmbajtjen e dosjeve të tyre personale", duhej të ishin marrë masat e duhura, ato më thelbësoret:

- 1- Rregullorja e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale, (pika 19) sipas këtij udhëzimi.
- 2- Deklarata e Konfidencialitetit, (pika 14, gërma "b"), sipas këtij udhëzimi.

Në përfundim të kontrollit administrativ, nga grupi i kontrollit u hartua procesverballi, i cili u lexua në pranë të përfaqësuesve të kontrolluesit, të cilët u shprehën se do të përmbushin konstatimet e shprehura në proces verbal dhe do i paraqesin ato para seancës dëgjimore. Përfaqësuesit e kontrolluesit nuk paraqitën pretendime.

Si shkelje konstatohet, koha e pacaktuar e mbajtjes së të dhënave sensitive të nxënësve me probleme sociale, nxënësve me probleme të shëndetit mendor, dhe nxënësve problematikë në sjellje. Ky fakt, është i konstatuar në të gjitha DAR-et e vendit. Mosnjohja e ligjit dhe akteve nënligjore të tij, janë evidente. Udhëzimi nr.4, datë 16.03.2010 i Komisionerit, "Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit" paragrafet 3 dhe 4, detyrojnë kontrolluesin në marrjen e masave të sigurisë, dhe njëkohësisht i rezervon kontrolluesit vlerësimin për kohën e mbajtjes së të dhënave apo fshirjen e tyre nëse nuk janë të nevojshme.

DAR Fier, po ashtu dhe të gjitha DAR-et në vend, kanë vetëm një adresë zyrtare, për komunikimin elektronik gjatë ushtrimit të detyrës, dhe komunikimi zyrtar kryhet nëpërmjet adresave personale elektronike të punonjësve. Kjo është një shkelje flagrante, jo vetëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, por dhe për vetë sistemin arsimor në tërësi, pasi komunikimi administrativ zyrtar i kryer nëpërmjet postës elektronike personale të punonjësve, i heq të drejtat kontrolluesit mbi këtë komunikim.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", datë 30.04.2015, në datë 19.07.2016, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ.

Në seancë dëgjimore, përfaqësuesi i kontrolluesit paraqiti të formalizuar rregulloren e D.A.R. Fier, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", bashkangjitur urdhrin e titullarit të kontrolluesit, "Për rregullimin e konstatimeve të inspektimit nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili daton më 28.06.2016. U paraqiti nga ana e përfaqësuesit të kontrolluesit një format i deklaratës së konfidencialiteti të nënshkruar nga X punonjës, si dhe u relatuan prapësimet, të cilat në formën shkresore u depozituan pranë sekretarisë, duke bërë me dije si më poshtë:

1-Në vitin 2011 është plotësuar nga DAR Fier, Formulari i Njoftimit, dhe faktohet në regjistrin e Komisionerit.

2-DAR Fier nuk dispononte një rregullore për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, por në gjitha proceset që janë kryer, është nënshkruar formulari i konfidencialitetit nga personat që merren me përpunimin e të dhënave personale. Gjithashtu DAR Fier, menjëherë pas konstatimit hartoi rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale.

3- DAR Fier, ka aplikuar Deklaratën e Konfidencialitetit për të gjitha proceset të cilat janë përpunuar të dhëna personale etj...

4-Lidhur me dosjet e krijuara nga psikologët janë Dispozitat Normative 2013 të cilat përcaktojnë qartësisht rregullat e privatësisë dhe detyrimin e psikologut për ruajtjen e privatësisë dhe ligji për 69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor në RSH.

5-Nuk kemi shkelje të nenit 27 dhe 28 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe janë marrë masat për sigurinë e tyre.

Zyra e Komisionerit, në lidhje me pretendimet e mësipërme vlerëson:

1- Faktohet në regjistrin e Komisionerit se është plotësuar Formulari i Njoftimit, nga DAR Fier.

2-Mungesa e një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, do të thotë mungesë masash paraprake, me qëllim parandalimin e kundravajtjes. Si e tillë, mungesa e rregullores është një shkelje parashikuar në ligj, konkretisht në nenin 27 të tij, i penalizueshëm sipas nenit 39, paragrafi 1, gërma "dh" i tij, i cili shprehet:

"...kontrolluesit që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të përcaktuara në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë".

Fakti që pranohet shkresërisht: "Gjithashtu DAR Fier, menjëherë pas konstatimit hartoi rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale.", tregon qartësisht mungesën e kësaj rregulloreje. Pavarësisht se DAR Fier ka reflektuar gjatë ushtrimit të detyrës me parime dhe elementë të mbrojtjes së të dhënave personale, kuadri i masave parandaluese nuk është i plotë sipas Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe veçanërisht Udhëzimit të MAS-it Nr.12, datë 27.04.2015 "Për mbledhjen përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe përmbajtjen e dosjeve të tyre personale". Ministria e Arsimit dhe Sportit, ka vlerësuar të pamjaftueshëm elementët dhe parimet e përmendura sipas Dispozitave Normative 2013, apo Ligji "Për arsimin në RSH", duke hartuar këtë akt, i cili daton të jetë më i fundit dhe më i plotë në marrjen e masave për ruajtjen e të dhënave personale.

3-Deklarata e Konfidencialitetit, e depozituar në seancë dëgjimore, është i formatit të AKP-së. Ajo është formatuar si e tillë, vetëm për një proces pune; atë të mbikëqyrësit i cili ka detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit vetëm përgjatë procesit të Maturës Shtetërore 2016, (pika 2 e kësaj deklarate). Kur flasim për Deklaratë Konfidencialiteti, në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, por dhe në kuptim të Udhëzimit të MAS-it Nr.12, datë 27.04.2015, duhet të kuptojmë që punëmarrësi është i detyruar të ruajë konfidencialitetin për të gjitha proceset e punës, dhe përgjatë gjithë kohës që ai akseson të dhëna personale.

Kontrolluesi, *Drejtoria Arsimore Rajonale Fier*, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe, sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dylfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e mësipërme konsistojnë në moszbatim të ligjit, akteve nënligjore dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ato lidhen me cënimin e sigurisë së të dhënave personale, kryesisht të subjekteve të të dhënave "nxënës" dhe "mësues".

### PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 27, 28, 39 paragrafi 1, gërma "dh", si dhe nenit 39, paragrafi 2 i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar,

### V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit *Drejtoria Arsimore Rajonale Fier*, me gjobë në vlerën **50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit *Drejtoria Arsimore Rajonale Fier*, me gjobë në vlerën **50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
3. Kontrolluesi, *Drejtoria Arsimore Rajonale Fier*, të realizojë për Zyrat Arsimore të cilat janë në varësi të tij, pajisjen e kontratave të punëmarrësve me Deklaratat e Konfidencialitetit sipas

Vendimit Nr.6, datë 05.08.2013 të Komisionerit, si dhe të shtrijë efektet e rregullores së formalizuar për mbrojtjen e të dhënave personale pranë tyre, brenda një periudhe 3 mujore.

4. Kontrolluesi, *Drejtoria Arsimore Rajonale Fier.*, në përputhje me Udhëzimin Nr.4, datë 16.03.2010 të Komisionerit "Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit", pikat 3 dhe 4, si dhe në përputhje me kushtet në të cilat ushtron detyrat, të reflektojë dhe të përcaktojë afatet proporcionale të mbajtjes të të dhënave personale sensitive, për nxënësit me probleme sociale, nxënësit me probleme të shëndetit mendor, dhe nxënësit problematikë në sjellje.
5. Kontrolluesi, *Drejtoria Arsimore Rajonale Fier.*, në përputhje me nenin 5, gërma "c", të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të mos publikojë ID-në personale të mësuesit aplikant.
6. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 29.07.2016

Besnik DERVISHI  
  
KOMISIONERI  
